

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAMI MËSIMOR

LËNDA:EDUKIM FIGURATIV

(klasa e shtatë)

Tiranë, 2005

- I. SYNIMI
- II. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM TË LËNDËS
- III. STRUKTURA E PROGRAMIT
- IV. PROGRAMI ANALITIK PËR KLASËN E SHTATË
- V. OBJEKTIVAT SPECIFIKË PËR ÇDO LINJË
- VI. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT
- VII. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE
- VIII. LIDHJA ME JETËN DHE MJEDISIN
- IX. MJETET DHE PËRDORIMI I TYRE
- X. UDHËZIM PËR HARTIMIN E TEKSTIT TË EDUKIMIT FIGURATIV

I. SYNIMI

Programi i edukimit figurativ në klasën e shtatë ka për qëllim t'i formojë nxënësit për të kuptuar artin figurativ duke u shprehur nëpërmjet tij.

Ky program i pajis nxënësit me njohuri, aftësi, qëndrim dhe vlera në një shkallë më të lartë vështirësie.

Ata marrin:

Njohuri:

- a) Për bazën materiale, proceset dhe teknikat, për përdorimin e tyre në përshtatje me këtë nivel;
- b) Të reja për elementet dhe parimet, duke i rimarrë disa prej tyre në një shkallë më të lartë vështirësie;
- c) Për përdorimin dhe ndërthurjen (e elementeve dhe të parimeve) me linjat e tjera në mënyrë harmonike;
- d) Për përdorimin e simboleve e tematikave të larmishme në shërbim të idesë dhe përdorimin e bazës materiale e të teknikave të ndryshme në shërbim të përmbajtjes;
- e) Për historinë e kulturës në periudha të ndryshme, për artin e mesjetës shqiptar, arkitekturën në lidhje me historinë.

Aftësi:

- a) Për vëzhgimin e elementeve e të parimeve të artit në natyrë dhe identifikimin e tyre në vepra arti, për të dalluar stile të artistëve të ndryshëm;
- b) Për përshkrimin dhe shpjegimin e veprave të artit të artistëve të ndryshëm në periudha të ndryshme dhe krahasimin e tyre;
- c) Për të përzgjedhur elementet e parimet në shërbim të temës;
- d) Për zbatimin e njohurive të marra në këtë nivel në krijimtarinë e tyre artistike;
- e) Për shpjegimin dhe vlerësimin e punës së tij dhe të shokut duke u mbështetur në njohuritë e marra në këtë lëndë deri tani;
- f) Për të bashkëpunuar dhe për të krijuar në grup, duke pranuar e duke respektuar mendimin e shokut;
- g) Për t'i përdorur njohuritë e marra në këtë lëndë në jetën e përditshme dhe mjedisin ku jeton.

Shkathtësi:

- a) Për përdorimin e bazës materiale dhe të teknikave në mënyrën dhe në kohën e duhur;
- b) Për përdorimin e fjalorit të përshtatshëm artistic, të pasuruar më tepër me këtë nivel;
- c) Për të komunikuar mendime, ide, emocione nëpërmjet temave të larmishme.

Qëndrime:

- a) Për të krijuar në mënyrë të pavarur në bazë të njohurive të marra në këtë nivel;
- b) Të mbajë qëndrim kritik ndaj një vepre arti;
- c) Për të mbrojtur punën e tij dhe për të marrë përgjegjësi;
- d) Për të respektuar mendimin e tjetrit.

Vlera:

- a) Për respektimin e traditave, të zakoneve dhe kulturave të vendit dhe të huaja dhe për rivlerësimin e tyre në ditët e sotme;
- b) Për realizimin e detyrave të klasës dhe të shkollës me seriozitet dhe përgjegjësi.

II. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS

Në fund të klasës së shtatë nxënësi të jetë i aftë:

- Të prodhojë punë me dy e tre përmasa që komunikojnë ide (mendime, ndjenja, përvoja) për qëllime të caktuara dhe për një nivel të caktuar, duke përdorur format e duhura të artit;
- Të identifikojë parimet e artit (theksin, ritmin, barazpeshën, unitetin, lëvizjen, kontrastin, harmoninë) dhe t'i përdorë ato në mënyrë të përshtatshme për këtë nivel, kur prodhon punë arti;
- Te shpjegojë sesi zgjedhjet artistike ndikojnë vrojtuesin, të mbrojnë përfundimin e tij duke u mbështetur tek vepra e artit;
- Të përdorë në mënyrë të saktë fjalorin dhe terminologjinë e artit në përshtatje me këtë nivel.

III. STRUKTURA E PROGRAMIT

Ky program është mbështetur mbi 6 linja, të cilat krijojnë një bazë të fuqishme për të arritur objektivat kryesorë të të mësuarit.

- Baza materiale, procese e teknika;
- Elemente dhe parime;
- Tematika;
- Histori dhe kulturë;
- Analiza, interpretimi, vlerësimi;
- Lidhjet ndelëndore dhe me mjedisin.

IV. PROGRAMI ANALITIK PËR KLASËN E SHTATË

	35 javë x 1 orë/javë	35 orë
-	Baza materiale, procese e teknika	4 orë
-	Elemente dhe parime	17 orë
-	Tematika	2 orë
-	Histori dhe kulturë	3 orë
-	Analiza, interpretimi, vlerësimi	3 orë
-	Lidhjet ndelëndore dhe me mjedisin	4 orë
-	Orë në dispozicion	2 orë

Linja I. Baza materiale, proceset, teknikat

(4 orë)

Nxënësi te njohë, të përzgjedhë dhe të përdorë materiale, mjete, procese e teknika.

Ai duhet:

- Të aftësohet në përdorimin e bazës materiale, të teknikave dhe proceseve që do të përdorë në këtë klasë, si: lapsi, goma, letra, ngjitësi, akuareli, vizatimi, tempera, kolazhi, instalacioni, plastelina, stampimi, skulptura, fotografia, kompjuteri etj.
- Të përzgjedhë mjetin e duhur për të ilustruar njohuritë e marra tek linja "Elemente dhe parime".
- Të përzgjedhë mjetin e duhur për të ilustruar llojet e ndryshme të linjave (p.sh., lapsin, stilolapsin, penën, rapidin, lapustilën, karbonin, penelin etj.).
- Të përdorë teknikën e vizatimit për t'u dhënë objekteve volum dhe peshë.

- Të përdorë temperat për të krijuar vlerat e ngjyrave.
- Të përdorë teknikën e përshtatshme për të ilustruar sipërfaqen (p.sh., kolazhin ose pastelet).
- Të përdorë penën ose rapidin si mjet për teknikat e grafikës për të ilustruar kontrastin.

Linja II. Elemente dhe parime

(17 orë)

Nxënësi të njohë e të përdorë elementet e parimet e artit në punimet e tij.

Vijat

- Të njohë dhe të përdorë në krijimet e tij karakteristikat e vijës (e dhëmbëzuar, zigzage, e pikëzuar, e harkruar, horizontale, vertikale, diagonale).
- Kompozimin me të cilin përdoren karakteristika linjash të ndryshme për të krijuar një gjendje të caktuar. (1 orë)

Format dypërmasore

- Të dallojë format organike që gjenden në natyrë (ato janë forma të lira dhe jo të rregullta).
- Kolazh me objekte të gjetura në natyrë, si: gjethe, fije, shkopinjtë etj. (1 orë).

Format trepërmasore

- Të njohë, të kuptojë dhe të dallojë që forma ka volum dhe peshë (vizatim objekti nga natyra ose krijim në plastelinë). (2 orë)

Vlera

- Të krijojë rrethin e madh të ngjyrave nëpërmjet të bardhës për të ndriçuar ato dhe nëpërmjet të zezës për të errësuar (ushtrime parktike për të kuptuar vlerat e ngjyrave, me tempera ose akuarel). (1 orë)

Sipërfaqja

- Të njohë sipërfaqen si një element të rëndësishëm të artit, duke e kuptuar atë në dy mënyra: nëpërmjet të prekurit dhe të parit.
(Bisedë në klasë e ilustruar me objekte me cilësi të ndryshme sipërfaqeje dhe me fotografi veprash arti, ku cilësitë e sipërfaqeve të objekteve të pikturuara dallohen nëpërmjet të parit). (1 orë)

Ngjyra

- Të krijojë rrethin e madh të ngjyrave (ngjyrat parësore, dytësore dhe të ndërmjetme). (1 orë)

Barazpeshë

- Të përdorë barazpeshën formale në krijimin e tij (krijim i një dekoracioni simetrik me motive popullore). (2 orë)

Theksi

- Të krijojë theksin në kompozim duke përdorur kontrastin (ilustrimi i një pjese letrare ku nxënësi nëpërmjet kontrastit që krijon në kompozim, thekson objektin ose personazhin më të rëndësishëm). (2 orë)

Lëvizja

- Të kuptojë që lëvizja na ndihmon të vëzhgojmë një vepër arti (bisedë e ilustruar me vepra arti në klasë ose në një galeri artesh). (1 orë)

Uniteti

- Të krijojë duke përdorur e njëzuar (shkuar) elementet e parimet e artit (krijimi i lirë ku nxënësi të përdorë njohuritë e marra për ngjyrën, linjën, formën etj., në shërbim të kompozimit të tij në mënyrë sa më harmonike). (2 orë)

Kontrasti

- Të krijojë kontrastin në një krijim duke përdorur lloje të ndryshme linjash, formash, ngjyrash etj. (p.sh., krijim “Nata dhe dita”, përdorimi i ngjyrave të errëta dhe të çelëta për të krijuar kontrastin etj). (2 orë)

Harmonia

- Të krijojë harmoni në një krijim duke përdorur ritmin (përsëritjen e organizuar të një ose më shumë elementeve të artit).
(Stampim me patate ose çfarëdo ku ritmi krijohet nëpërmjet përsëritjes së formave e ngjyrave). (1 orë)

Linja III. Tematika

(2 orë)

Nxënësi të shqyrtojë, të përzgjedhë dhe të përdorë shumëllojshmëri temash, simbolesh, idesh nga jeta e tij. Ai duhet:

- Të përzgjedhë elementet e parimet e artit në shërbim të temës.
- Të përzgjedhë bazën materiale e teknikën në shërbim të përmbajtjes.
- Të komunikojë ndjenja mendime nëpërmjet temave të larmishme.

Krijim punë në grup.

(2 orë)

Linja IV Historia dhe kultura

(3 orë)

Nxënësi të kuptojë edukimin figurative në lidhje me historinë dhe kulturën. Ai duhet:

- Të njohë dhe të krahasojë vepra arti të periudhave të ndryshme historike (p.sh., të dallojë artin bizantin nga Rilindja Italiane, impresionizmin, realizmin etj.) (1 orë)
- Të njohë artin mesjetar shqiptar dhe artistët më të njohur të kësaj periudhe, Onufri, David Selenica, vëllëzërit Shpataraku etj. (1 orë)
- Të njohë arkitekturën në lidhje me historinë (ndërtesat më të njohura e më të spikatura, p.sh., Koloseun në Romë, Harkun e Trumfit në Paris, Kishën e Shën Pjeterit, Kullën Eifel, piramidat etj.) (1 orë)

Linja V. Analiza, interpretimi dhe vlerësimi

(3 orë)

Nxënësi të vëzhgojë, të përshkruajë, të analizojë, të interpretojë dhe të vlerësojë punimet e tij dhe të shokut. Ai duhet:

- Të njohë dhe të kuptojë dritën si një faktor shumë i rëndësishëm natyror, e cila bën të mundur perceptimin tonë për elementet e artit: ngjyra, sipërfaqja, forma etj. (kjo orë mund të zhvillohet në formën e një bisede, ku nxënësit vënë në përdorim njohuritë e marra në fizikë, ose mund të jetë një bashkëpunim i mësuesit të fizikës dhe të edukimit figurativ).
- Të analizojë e të vlerësojë punën e tij dhe të shokut.
- Të analizojë elementet e parimet e artit të mësuar në këtë nivel në vepra arti (bisedë për vepra të ndryshme arti, ilustrime të gjetura nga mësuesi dhe nga vetë nxënësit).

Linja VI. dhja ndërlëndorë dhe me mjedisin

(4 orë)

Nxënësi të bëjë lidhjet mes arteve pamore dhe disiplinave të tjera në jetën e përditshme. Ai duhet:

- Të kuptojë se çfarë e bën një objekt vepër arti.
- Të identifikojë marrëdhëniet e artit me jetën e përditshme (instalacion me objekte të ndryshme) (1 orë)
- Të krijojë, të stilojë një veshje moderne duke u mbështetur në traditën popullore të veshjes. (3 orë)

VI. METODOLOGJIA E REALIZIMIT TE PROGRAMIT

Në qendër të metodologjisë së lëndës së edukimit figurative (artit pamor) është përvoja dhe aftësia e nxënësit, të cilat i formon, i përmirëson dhe i edukon

vazhdimisht gjatë procesit mësimor dhe jashtë tij. Të mbahet parasysh që në këtë klasë nxënësi vjen me një përvojë dhe aftësi të formuar për moshën nga programi i artit pamor të ciklit fillor dhe të klasës VI. Mësuesi të përdorë forma të larmishme, si:

- Vëzhgimi\ilustrimi.
- Zbërthimi i saktë i temës dhe njohurive.
- Nxitja e veprimtarisë së pavarur.
- Zgjerimi i njohurive për konceptin e marrë.
- Vlerësimi artistik etj.

Karakteristikë e rëndësishme në këtë klasë, si në të gjithë programin, është liria vetjake në krijim, e cila do të thotë që nxënësi të zbatojë njohuritë e marra nga programi duke ua përshtatur stilit të tij të punës dhe ëndërrimeve të tij.

Është shumë e rëndësishme që bashkëpunimi mësues-nxënës gjatë procesit mësimor të mbështetet edhe në përvojën vetjake të nxënësve.

VII.UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësve në këtë nivel do të bëhet në bazë të arritjeve që realizon në veprimtarinë praktike e krijuese, sa ai arrin të realizojë në praktikë njohuritë e marra. Një mënyrë tjetër vlerësimi është edhe aftësia analizuese e vlerësuese që nxënësi i bën punës së tij, të shokut apo edhe një veprë arti. Ky lloj vlerësimi mund të jetë edhe orë më vete kur kemi analizën e veprave të artit, por mund të jetë edhe në fund të një teme të caktuar, kur në diskutim marrin pjesë të gjithë nxënësit. Vlerësimi mund të bëhet ose jo pas çdo teme mësimore ku mësuesi duhet të shfaqë mendimin e tij për çdo krijim të nxënësit.

VIII.LIDHJA ME JETËN DHE MJEDISIN

Nëpërmjet artit figurativ nxënësit do të dallojnë lidhjet e kësaj fushe arti me llojet e tjera të artit, me lëndët e tjera mësimore dhe me mjedisin ku zhvillohet. Kjo lëndë tregon sesa i lidhur është arti figurativ me jetën tonë të përditshme, duke u siguruar mundësinë nxënësve që të krijojnë punë të ndryshme, duke ndërthurur artin pamor me forma të tjera të artit. Kështu, p.sh., nxënësi mund të krijojë mbasi ka dëgjuar një pjesë muzikore, mund të lidhë një datë historike me një etapë të zhvillimit të edukimit figurativ etj.

IX. MJETET DHE PERDORIMI I TYRE

Përorimi i mjeteve në punimin artistik është i domosdoshëm për të arritur një nivel të kënaqshëm gjatë veprimtarisë mësimore. Është shumë e rëndësishme që çdo nxënës të ketë kutinë e tij të mjeteve të punës. Në pamundësi të çdo nxënësi me mjete vetjake, mund të përdoren mjetet në grup.

Mjetet më të rëndësishme janë:

Grupi i parë: shkumsa me ngjyra (tetë ngjyra), lapsa me ngjyra, gomë dhe laps i zi HB, lapustila, akuarelet, pastela.

Grupi i dytë: vinovil, letër ngjitëse, skoç, vizore, gërshtë.

Grupi i tretë: penela të ndryshme të disa madhësive, të cilat janë të përcaktuara në paketa të veçanta, fletore vizatimi, fletore punë dore, letër tabak, kartona me ngjyra, letër për të shkruar A4.

Grupi i katërt: aparat fotografik, (një për të gjithë klasën), kompjuter (sipas mundësive).

Grupi i pestë: mbajtëse për dosjet e punës, mbajtëse për mjetet, enë për të mbajtur ujë për pastrimin e penelave, si dhe për krijimin e ngjyrave me tempera, akualet.

Grupi i gjashtë: mjete për pastrimin, peshqirë të vegjël, kartëpeceta, gazeta.

Vendi i punës

Për të zhvilluar mësimin e edukimit figurative, është shumë e rëndësishme që nxënësi të punojë më një dritë të plotë, me një vend të sigurt ku mund të mbështesë mjetet e punës, në një vend të ngrohtë pa lagështirë, të pastër. Vendi më i mirë për orën e edukimit figurative është klasa-studio. Në pamundësi të saj, klasa të ketë kushtet e përshtatshme.

X. UDHËZIM PËR HARTIMIN E TEKSTIT TË EDUKIMIT FIGURATIV KLASA VII

Krijimi i një teksti mësimor për lëndën e edukimit figurativ në shkollën tonë sot është një domosdoshmëri, e cila përcillet nga zhvillimet e shoqërisë në përgjithësi, por edhe të kurrikulës së edukimit figurativ që zbatohet sot. Përsa i takon formimit të nxënësit, ky tekst do të ndihmonte shumë në formimin e tij të përgjithshëm artistik:

- duke krijuar njohuri teorike të qëndrueshme,
- duke dhënë mbështetje ilustrative,
- duke dhënë modele për analizat, vlerësimin, nxitjen e mendimit kritik nëpërmjet debateve, bisedave e vlerësimeve,
- duke pasuruar fjalorin artistik etj.

Puna e institucioneve dhe e grupeve të autorëve që do të marrin përsipër hartimin e teksteve për klasën e shtatë të arsimit të detyruar është e domosdoshme të përqendrohet në plotësimin e disa kriterëve që kanë të bëjnë si me këndvështrime të përgjithshme, ashtu edhe me këndvështrime më specifike shkencore e didaktike.

Teksti i lëndës së edukimit figurativ synon të sjellë në klasë, në miniaturë, mjedisin kulturor e artistik, në të cilin jetojnë nxënësit. Ai të krijojë lidhje të fuqishme bashkëpunimi krijues: nxënës - nxënës, mësues - nxënës, mjedis shkollor e jashtëshkollor.

Çështje të hatimit të tekstit

1. Teksti i lëndës së edukimit figurativ, si libër shkollor, të jetë në përputhje me programin e miratuar nga MASH. Ai të përmbushë të gjithë objektivat mësimorë e pedagogjike që përmbahen në të. Në këtë mënyrë teksti t'u pëmbahet qëllimeve të sistemit arsimor, në përgjithësi, dhe të programit, në mënyrë të veçantë.

2. Teksti nuk ka vetëm karakter detyrues apo udhëzues, por përdoret për studim vetjak. Autorët, duke patur një konceptim të qartë të procesit mësimor dhe të perceptimit të tyre për përmbajtjen e lëndës, mund të kthehen në një faktor nxitës në mësimdhënien e lëndës së edukimit figurativ.

3. Ndërtimi i tekstit të nisët nga parimi se nxënësi fiton njohuri nga veprimtaria e tij. Hartuesit të krijojnë kushte të tilla që nxënësi të veprojë duke u nxitur nga sa më shumë fusha ndijore dhe veçanërisht mendore. Vetëm kështu nxënësi merr njohuri të zbatueshme.

4. Të gjenden zgjidhje të frytshme në tekst që mësuesi të përçojë njohuritë në mënyrë sa më të saktë.

5. Të mbështetet në kërkesat didaktike të shkollës së sotme, duke përcjellë dhe përvojën bashkëkohore.

Teksti shkollor të mundësojë realizimin e objektivave në fushën e njohurive, të shprehive dhe të qëndrimeve.

Kjo do të thotë që teksti duhet të ofrojë, si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit, krijimin e situatave mësimore që mundësojnë realizimin e objektivave të

mësipërm. Këtu duhet të kujtojmë se veprimtaritë praktike nuk mund të shihen të ndara nga veprimtaritë krijuese.

- Është mirë që nxënësit të aktivizohen më parë në veprimtari praktike të tilla, si: vëshgimi, grumbullimi i matërialit paraprak nga nxënësi, biseda, vizitat në ekspozita, galeri, vende me arkitekturë të veçantë, shikim filmash, vizita në ndërmarrje artistike, studio arti.
- Sistemimi i dijeve në tema e në nëntema që t'i ndihmojë nxënësit të zërthejnë faktet nëpërmjet ushtrimit dhe të caktohen në tekst burime të tjera të informacionit.

Ushtrimet të jenë të tilla:

- ndijore (me albume pikturash, me punime të ndryshme artistike, me harta, me video, me filma);
- veprimtari praktike (me një bazë të caktuar materiale, si dhe me një teknikë të caktuar);
- veprimtari shprehëse (me krijim artistik);
- veprimtari mendore (analiza veçimi, krahasimi, dallimi, klasifikimi, ërgjithësimi, nxjerrja e përfundimit etj.).

Ushtrimet të planifikohen të tilla që të përforcojnë përmbajtjen, të kenë material njohës e ilustrues. Veprimtaria ndijore të përfshijë ilustrimet me punime të ndryshme artistike. Për këtë arsye është mjeshtëria e autorit të tekstit që të parashikojë ato veprimtari që mundësojnë realizimin në tërësinë e tyre të synimeve dhe të objektivave të lëndës.

- Teksti të përmbajë mësimë ose struktura mësimi të qarta, në formën e njësave mësimore, për të arritur objektiva të qartë mësimorë në përputhje me programin e dhënë dhe me standardet lëndore.
- Po kështu, në tekst mund të shfrytëzohet ose të nxitet edhe mundësia e marrjes së informacioneve të caktuara shtesë nga burime të tjera informacioni (tekste, shembuj didaktikë, foto të piktorëve, ekspozita, piktura të fëmijëve bashkëmoshatarë apo më të rritur, pamje të ndryshme të përdorimit të artit në mjediset familjare, në punë, shkollë, në zbulimin e mjedisit me mjete të krijimit të artit me dy e tri përmasa, të artit elektronik dhe ndikimet e tij në jetën e njeriut), gjë që do të bënte tekstin ose njësinë mësimore më të hapur dhe më pak monotone, duke rritur edhe mundësitë e punës së pavarur vetjake kërkimore të nxënësve.
- Nëse në tekst përdoren ilustrime, ato të bartin vlera kuptimore dhe emocionale që lidhen ngushtë me motivimin e nxënësve, me përmbajtjen e njësisë mësimore ose me objektiva të tjerë të programit.
- Informacionet shtesë (ilustrimet, fotot, shembujt ilustrativë etj.) t'i shërbejnë sqarimit më të mirë të koncepteve.
- Struktura e ndarjeve të tekstit, si dhe struktura e njësisë mësimore të tekstit (p.sh., tema) të jenë të njësuara gjatë gjithë tekstit.
- Faqosja e elementeve të ndarjeve mësimore (titujt, tekstet, ilustrimi figurativ, modelet etj.) të jenë tërheqëse dhe të mbështetura në procedurën logjike të shtjellimit të lëndës, në përgjithësi, dhe të temës, në veçanti.
- Përdorimi i hapësirave, nënvizimeve, sqarimeve, ngjyrave etj., të jetë në shërbim të çështjes që trajtohet.
- Numri i faqeve të librit të jetë 60 – 70 A4.
- Teksti duhet të jetë me katër ngjyra.

- Formati mund të jetë: Format i prerë 260 x 210